

## A MUND TË JETOU DHE TË PUNOJ NË SHITET E ZONËS SHENGEN SIPAS RREGULLAVE TË RELJA?

Rregullat e reja aplikohen vetëm për qëllime udhëtimi. Ato nuk u japin qytetarëve shqiptarë të drejtën për të qëndruar më shumë se 3 muaj, si dhe as të drejtën për t'u punësuar në këto shtete. Nëse keni ndërmend të punësoheni apo të studioni për një periudhë që tejkalon 90 ditët, **më parë** duhet të aplikoni për vizë afatgjatë ose për leje qëndrimi në ambasaden apo konsullatën e shtetit ku do të shkoni. Është e ndaluar të punoni në zonën Shengen pa leje pune apo të jetoni aty pa lejen përkatëse të qëndrimit.

Në rast se një qytetar shqiptar qëndron në zonën Shengen më shumë se 90 ditë pa pasur leje qëndrimi apo një leje tjetër afatgjatë, atëherë qëndrimi i tij është i jashtëligjshëm dhe, për rrjedhojë, mund të mos lejohet të hyjë sërish në zonën Shengen. E njëjta gjë vlen edhe për personat që punojnë në zonën Shengen (edhe për më pak se 90 ditë) pa pasur leje pune. Edhe në këtë rast, në të ardhmen atyre mund të mos u jepet e drejta për të hyrë në zonën Shengen.



## A EKZISTOJNË KËRKESA TË TJERA PËR TË HYRË NË KËTO SHITET?

Personave që zotërojnë pasaportë biometrike, në mënyrë që të udhëtojnë lirisht drejt shteteve Shengen, nuk u duhet të plotësojnë kërkesa të tjera financiare apo administrative. Megjithatë, qytetarëve nga vende të tjera mund t'u kërkohej në kufi të tregojnë mjetele e udhëtimi dhe mjetele e jetesës gjatë qëndrimit të tyre në zonën Shengen. Atyre mund t'u kërkohej të specifikojnë vendin ku do të qëndrojnë (p.sh. të tregojnë rezervimin e hotelit apo adresën e vendit ku do të qëndrojnë).

Gjithashtu, udhëtarët nuk duhet të konsiderohen si persona që përbejnë kërcënim për rendin, shëndetin publik apo sigurinë e brendshme. Ata nuk duhet të jenë persona ndaj të cilëve është dhënë ndonjë vendim për të refuzuar hyrjen në zonën Shengen. Autoritetet kufitare të shteteve anëtare kanë të drejtë të refuzojnë hyrjen e personave që nuk plotësojnë këto kërkesa dhe të vendosin përfundimisht nëse do të lejojnë hyrjen e atij personi në zonën Shengen.

## REKOMANDIME PËR UDHËTARËT

- Udhëtori me agjenci udhëtimi të besueshme.
- Kontrolloni a ju duhet sigurim shëndetësor dhe lloji i tij (dokumenti/ konfirmimi nga zyrat shëndetësore). Rekomandohet të pajiseni me sigurim shëndetësor përpara nisjes.
- Nëse udhëtori drejt zonës Shengen me automjet, duhet të pajiseni me leje ndërkombëtare drejtimi automjeti dhe me kartonin e gjelbër të sigurimit ndërkombëtar të makinave. Për më shumë informacion, përfshirë rregullat rrugore të BE-së, vizitoni faqen e internetit [http://ec.europa.eu/transport/road\\_safety/observatory/traffic\\_rules\\_en.htm](http://ec.europa.eu/transport/road_safety/observatory/traffic_rules_en.htm)
- Nëse udhëtori privatisht, përpikuni të kontrolloni adresën, qytetin, numrin e telefonit dhe emrin e hotelit të shtetit të zonës Shengen, për shëmbull në një faqe interneti.
- Numri i urgjencës është 112 dhe vlen për të gjitha shtetet anëtare të BE-së (për policinë, ambulancën dhe zjarrfikësin).



Delegacioni i Bashkimit Evropian në Shqipëri



Republika e Shqipërisë



# LËVIZJA E LIRË PA VIZA MBËRRITI EDHE PËR QYTETARËT E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

## LËVIZJA PA VIZA DREJT HAPËSIRËS SHENGEN MBËRRITI EDHE PËR QYTETARËT E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Duke filluar nga data 15 dhjetor 2010, qytetarët e Republikës së Shqipërisë nuk do të kenë nevojë për vizë për të udhëtuar në 25 prej shteteve anëtare të Bashkimit Evropian si dhe në 3 shtete të tjera jo-anëtare të BE-së, pjesë të zonës Shengen. Qytetarët e Republikës së Shqipërisë që kanë një pasaportë të vlefshme biometrike, mund të udhëtojnë pa vizë në këto shtete për periudha afatshkurtra deri në 90 ditë çdo gjashtë muaj (180 ditë), për qëllime biznesi, për studime apo për turizëm.

### NË CILAT SHTETE MUND TË UDHËTOHET PA VIZË?

Rregullat e reja zbatohen në të gjitha shtetet anëtare të Bashkimit Evropian përveç Mbretërisë së Bashkuar dhe Irlandës. Qytetarët shqiptarë mund të udhëtojnë pa vizë edhe në Islandë, Norvegji e Zvicër.

#### Lista e shteteve për të cilat nuk kërkohet vizë

|           |          |            |                |
|-----------|----------|------------|----------------|
| Austri    | Greqi    | Lituani    | Republika Çeke |
| Belgjikë  | Gjermani | Luksemburg | Rumani         |
| Bullgari  | Hollandë | Malte      | Slovaki        |
| Danimarkë | Hungari  | Norvegji   | Sloveni        |
| Estoni    | Islandë  | Poloni     | Spanjë         |
| Finlandë  | Itali    | Portugali  | Suedi          |
| Francë    | Letoni   | Qipro      | Zvicër         |

### PËRSE PËRJASHTOHEM MBRETËRIA E BASHKUAR DHE IRLANDA?

Mbretëria e Bashkuar dhe Irlanda janë jashtë zonës Shengen, për rrjedhojë rregullat e reja nuk aplikohen në këto shtete. Për informimin mbi kërkesat e hyrjes në këto dy shtete, qytetarët shqiptarë duhet të kontaktojnë Seksionin e Vizave në Ambasadën e Britanisë së Madhe në Tiranë dhe në Ambasadën e Irlandës në Greqi.

### SI MUND TA DALLOJ NËSE PASAPORTA IME ËSHTË BIOMETRIKE?

Shpërndarja e pasaportave biometrike në Shqipëri ka filluar që nga maji 2010. Shikoni me kujdes nëse pasaporta juaj ka këtë simbol në pjesën balllore të saj.



Nëse po, atëherë pasaporta juaj është biometrike dhe ju mund të udhëtoni me të lirisht në shtetet e sipërpërmendura.

### SI MUND TË PAJISEM ME PASAPORTË BIOMETRIKE, NËSE ENDE NUK E KAM NJË TË TILLË?

Nëse ende nuk keni pasaportë biometrike, duhet të bëni kërkesë në institucionet e autorizuar për dhënie e pasaportave në Republikën e Shqipërisë, për t'u pajisur me pasaportë të re, në mënyrë që të udhëtoni pa vizë në shtetet e sipërpërmendura.

### A MUND TË UDHËTOJ AKOMA ME PASAPORTËN TIME TË VJETËR JO-BIOMETRIKE?

Meqenëse pasaportat jo-biometrike nuk vlejnë për lëvizjen e lirë pa vizë, ju nuk do të mund të udhëtoni dot me këtë pasaportë drejt vendeve të hapësirës Shengen, nëse në të nuk keni vizë. Për informacione të mëtejshme, duhet të kontaktoni autoritetet e shtetit shqiptar ose përfaqësitë konsullore të shteteve Shengen.

### SIPAS RREGULLAVE TË REJA, SA KOHË MUND TË QËNDROJNË QYTETARËT SHQIPTARË NË ZONËN SHENGEN?

Sipas rregullave të reja, qytetarët shqiptarë me pasaportë biometrike mund të qëndrojnë në zonën Shengen, (që përfshin Islandën, Norvegjinë, Zvicrën, si edhe të gjitha shtetet anëtare të BE-së, përveç Mbretërisë së Bashkuar dhe Irlandës) maksimumi 90 ditë që nga dita e hyrjes brenda një periudhë kohore prej gjashtë muajsh (180 ditë). Periudha fillon që nga momenti kur ju hyni për herë të parë në këtë zonë, brenda periudhës gjashtë mujore. Për shembull, nëse me datë 1 janar ju hyni për herë të parë në zonën Shengen, periudha e ardhshme gjashtë mujore fillon me datë 1 korrik. Nëse udhëtoni shpesh në zonën Shengen, duhet të numëroni ditët e mbetura nga periudha gjashtë mujore. Pra, ju mund të bëni disa udhëtime afatshkurtra, me kusht që kohëzgjatja e tyre të mos kalojë 90 ditët brenda periudhës gjashtë mujore (180 ditë).

